

Objektivat orientuese të planit të zbatimit të dënimit

Shënim paraprak: Për lehtësi leximi, këtu në draft do të përdoret vetëm gjinia mashkullore. Në planin e zbatimit të dënimit për institucionin ndëshkimor JVA të Hindelbank, do të përdoret gjinia femërore.

1. Sjellja korrektuese në përgjithësi
Objektivi orientues: I dënuari kontribuon në bashkëjetesën e sigurt dhe të rregullt brenda institucionit ndëshkimor. Shmanget nga çdo veprim që mund të lëndojë, rrezikojë ose kërcënojë integritetin e të tjerëve. Punon në mënyrë aktive për arritjen e objektivave personale për zbatimin e dënimit. Objektivi afatgjatë është një stil jetese pa kriminalitet.
2 Shëndeti/Sëmundjet (duke përfshirë varësitë)
Objektivi orientues: I dënuari kujdeset në mënyrë aktive për shëndetin e tij. I shfrytëzon mundësitë aktuale që instituti ndëshkimor vë në dispozicion.
3 Banimi
Objektivi orientues: I dënuari kujdeset që të ketë një marrëdhënie korrekte me të dënuarit e tjerë. Ai zbaton dhe zgjeron, sipas nevojës, kompetencat e tij shoqërore dhe aftësitë praktike të jetës së përditshme.
4 Puna
Objektivi orientues: Përmes punës, i dënuari ruan aftësitë e tij profesionale dhe shoqërore ose i zhvillon ato edhe më tej, sipas mundësisë.
5 Terapia mjekoligjore/përballja me veprën penale
Objektivi orientues: Në rastin e një terapie të urdhëruar, do të kryhet një trajtim i orientuar në çrregullimet dhe veprat penale. I dënuari punon në mënyrë aktive drejt objektivave të tij individuale terapeutike. Çdo i dënuar trajtohet sipas veprës së tij penale. Ai i njuh veprimet e tij që çuan në veprën penale. I njuh sinjalet që mund të çojnë sërish në kryerjen e një vepre penale. Së fundi, ai zotëron strategji veprimi për menaxhimin e situatave të rrezikut, pa kryer vepra penale.
6 Dëmshpërblimi material
Objektivi orientues: I dënuari jep një kontribut të përshtatshëm për dëmshpërblimin material (në rast të shërbimeve me urdhër gjykate) ose kujdeset ta zgjidhë atë vetë (pa urdhër gjykate).
7 Shkollimi dhe trajnimi
Objektivi orientues: I dënuari fiton ose zhvillon më tej aftësitë edukative dhe profesionale. Ai shfrytëzon ofertat ekzistuese, për të kompensuar deficitet arsimore dhe/ose për të zgjeruar kompetencat e tij profesionale.
8 Koha e lirë
Objektivi orientues: I dënuari i njuh interesat e tij dhe e shfrytëzon kohën e lirë pozitivisht në mënyrë aktive dhe sociale.

9 Financat

Objektivi orientues: I dënuari e përdor pagën e fituar gjatë punës në zbatim të dënimit në mënyrë ekonomike. Ai e njej gjendjen e tij financiare dhe i administron financat e tij në mënyrë të përgjegjshme.

10 Lidhja me botën jashtë

Objektivi orientues: I dënuari, përpiqet brenda mundësive të kujdeset për marrëdhëniet dhe kontaktet e tij të jashtme, të cilat janë pozitive për arritjen e objektivave të zbatimit të dënimit dhe riintegrimin e tij në shoqëri pas lirimit.

11. Zbutja e zbatimit të dënimit, shkallët e progresit

Objektivi orientues: Zbutja e zbatimit të dënimit shërben për t'u kujdesur për marrëdhëniet shoqërore dhe për ruajtjen e aftësive vepruese në kushte shoqërore normale, në kuadër të riintegrimit.

Kërkesa të përgjithshme: Zbutja e zbatimit të dëbimit/shkallët e progresit do të kontrollohen nëse janë përmbushur afatet dhe kushtet ligjore. Kusht paraprak është pjesëmarrja aktive për arritjen e objektivave të planit të zbatimit të dënimit. Nuk duhet të ketë asnjë situatë e pafavorshme lidhur me rrezikun e arratisjes ose të ndonjë vepre penale (në kuadër të zbutjes së zbatimit të dënimit).

12 Përgatitja për lirim

Objektivi orientues: Personi i dënuar ka perspektiva realiste për kohën kur do të jetë liruar. Është i përfshirë në mënyrë aktive gjatë përgatitjes. Në momentin e lirimit, ai ka një strehë banimi dhe një vend pune (ose një organizim të rregullt të ditës) dhe gëzon lidhje shoqërore. Sigurimi financiar është i garantuar (gjatë riintegrimit në Zvicër).

Grupi i punës për planin e zbatimit të dënimit/raportit të zbatimit të dënimit, 27.4.2018